

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 13.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Proinfo ICT" për aktivitetin :"**Implementimi i sistemit të menaxhimit elektronik të automejteve me paisje GPS**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-2881-221 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa e Operatorit Ekonomik "Proinfo ICT" e datës 13.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Implementimi i sistemit të menaxhimit elektronik të automejteve me paisje GPS**", me Nr.616 19 2881 221, kundër Njoftimit për kontratë e AK-së ,të datës 09.05.2019, të publikuar në E Prokurim;
2. Vërtetohet Njoftimi për kontratë i datës 09.05.2019 dhe AK-ja vazhdon aktivitetin
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Proinfo ICT" me datë 13.05.2019 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Implementimi i sistemit të menaxhimit elektronik të automejteve me paisje GPS**". Autoriteti Kontraktues, me datë 16.05.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:
-Tenderuesi në bazë të njoftimit për kontratë ka kërkuar sqarime lidhur me specifikimet teknike me datën 09.05.2019 dhe Autoriteti Kontraktues ka dhënë sqarimet e veta në të cilat janë dhënë arsyet që e detyrojnë AK-ne të kërkojë specifikime të tilla e që respektivisht ka të bëjë me detyrimin që kërkesat të përshkruajnë një instalim të bërë me parë me tender publik, mirepo sqarimet tona nuk i ka trajtuar si të mjaftueshme.

I sqarojme se AK-ja ka dhene te gjitha sqarimet e mundshme dhe pasiqe edhe pretendimet ne kerkesen per rishqyrtim jane te njejtat, kerkesa trajtohet si e pa bazuar dhe refuzohet si e tille.

Nga konstatimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

Verejtje:Pala e pakenaqr me kete Vendim mund te parashtroj ankese ne OSHP ne afatin prej 10(dhjete) diteve nga dita e pranimi te te njejtit.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit